




Albert Bishaj  
A  
Antoni Durrës  
Fuca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 218 / Prot.  
9

Vlorë më, 21.11.2024

**VENDIM**

Nr. 79 datë 20.11.2024

**PËR**

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË  
"INXHINIERI ELEKTRIKE", (DIPLOMË E DYFISHTË) NË FAKULTETIN E  
SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026  
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh , nenit 73, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, si dhe propozimit të Zëvendësrektorit Akademik, përcjellë me shkresën 2651, prot, datë, 19.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.11.2024,

**VENDOSI**

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare , në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore për riorganizimin e programit të studimit Bachelor në " Inxhinieri Elektrike" (Diplomë e Dyfishtë) sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit Akademik, Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore si dhe Drejtoria e Ciklit të Parë dhe të Dytë të Studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Aurela Saljaj**

